




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: "EL-BAU" SH.P.K., me seli Gjilan, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 26.04.2021, merr këtë:

V E N D I M

- 1. Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e pasuksesshëm, të subjektit në procedurë: "EL-BAU" SH.P.K., me seli në Gjilan, në procedurën e prokurimit me titull: " Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugeve lokale me infrastruktur, Prokurimi: VU644-20-6595-5-2-1, Nr. i brendshëm: VU644-20-083-521
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 13.04.2021

A r s y e t i m

Organi Shqyrtues i Prokurimit,(më tej (OSHP), në Vendimin e tij nr. 177/21 dt. 25.03.2021 në mes tjerash ka anuluar Njoftimin mbi Vendimin për Dhënie të Kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit : Rekonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastrukturë, me nr. prok. 644-20-6595-5-2-1 Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 083 – 521, ndërsa lënda është kthyer në Ri-vlerësim.

Në zbatim të Vendimit të OSHP-së nr. 177/20 të dt.25.03.2021, bazuar dhe në nenin 59 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues (më tej A.K.) ka zbatuar procedurën e Ri-Vlerësimit të tenderëve të cilët kanë qenë subjekt të çështjes procedurale, dmth O.E. të cilët kane pasur legjitimacionin aktiv në çështjen e cila është shqyrtuar dhe vendosur nga OSHP, duke ardhur ne konstatimet si në vijim.

Procedura e Ri-vlerësimit të tenderëve është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 60 paragrafi 1 pika 1.1 (**tenderi i përgjegjshëm me çmimin për njësi të peshuar**) ka pasur për qëllim që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve, të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët të peshuar.**

Organi Shqyrtues i Prokurimit, në tekstin e mëtejme (OSHP) në Vendimin e tij nr. 177/21 dt. 25.03.2021 duke vlerësuar tenderin e O.E. " Urban O.P. " të rekomanduar për dhënie të kontratës dhe të O.E. tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, ka ardhur në përfundimin se tenderët e O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, përjashtuar tenderin e Ankuesit " El-Bau "sh.p.k., në Paramasë/Parallogarinë e tyre, në 2-3 pozicione , kanë ofruar çmime Jo-Normalisht të ulëta në krahasim me lëndën e kontratës, rrjedhimisht nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomik, duke obliguar A.K. që ti zbatoi të gjitha dispozitat e LPP-së me rastin e rivlerësimit, duke zbatuar rregullat për tenderin Jo-Normalisht të ulët si dhe të veproi në harmoni me të gjitha pikat e nënti 59 të LPP-së.

Bazuar në përfundimet e nxjerra nga OSHP lidhur me procesin e vlerësimit të tenderëve nga A.K., në procesin e Ri-vlerësimit të tenderëve të O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit,

mbështetur në nenin 59 të LPP-së dhe nenin 3.2 të Rregullave për tenderët Jo-Normalisht të ulët, A.K. , në pajtim me nenin 4 të Rregullave për tenderët Jo-Normalisht të ulët, me shkrim ka kërkuar Informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët në pozicione të caktuara. Bazuar në përgjigjen, shpjegimet dhe dëshmitë e dorëzuara prej O.E. , A.K. ka vlerësuar se dëshmitë e dorëzuara : Marrëveshja e lidhur me shkrim me KRM "Uniteti "sh.a dhe Deklarata me shkrim e lëshuar – ofruar nga kompania " Tehnoburimi D.D. " sh.a. e cila është prodhuese e shtyllave elektrike me bazë nga betoni, për A.K. paraqesin, deri në një masë, shpjegim dhe argument të mjaftueshëm lidhur me bazën e tenderit të O.E. Ndërsa, po ashtu, në pajtim me nenin 30.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik më tej (RUOPP), A.K. ka kërkuar nga O.E. që përqindja e Sigurimit të Ekzekutimit të kontratës të rritet nga 10% në 30% për arsye se O.E. ka dorëzuar tender jo-normalisht të ulët dhe, si masë sigurie për A.K. për mbulimin e dëmeve dhe shpenzimeve që A.K. eventualisht mund të ketë në rast se do të vije deri te shkëputja e kontratës. Edhe lidhur me këtë kërkesë, A.K. , në rrugë elektronike, ka pranuar konfirmimin e pranimit të kësaj kërkesë nga O.E. se në rast se rekomandohet për dhënie të kontratës do të dorëzoi Sigurimin e Ekzekutimit të Kontratës në masën 30% nga vlera e parashikuar e kontratës.

Më tej A.K., mbi bazën e dëshmimeve të dorëzuara nga O.E., mbështetur në përfundimet e nxjerra nga procesi i Ri-vlerësimit të tenderëve pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit në fjalë, bazuar në dispozitat e nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, lidhur me nenin 52 paragrafi 1 dhe nenin 28 të RUOPP Kriteri për Dhënien e Kontratës si dhe nenin 116 pika 6 të LPP-së sipas të cilit, citat : ***“ Një vendim i OSHP-së për Ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar “*** mbarim citati, padiskutueshëm ka konstatuar se tenderi i O.E. " Urban O.P." është i përgjegjshëm për arsye se dëshmitë, siç është përshkruar në Seksionin II. Fleta e Të Dhënave të Tenderit (FTD) të Dosjes së Tenderit i përmbush në tërësi. Po ashtu A.K. gjatë procesit të Ri-vlerësimit të tenderëve ka pasur parasysh dhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, " Qëllimi " që nënkupton se : ***“ fondet publike duhen siguruar të shfrytëzohen në mënyrë efikase, transparente , bazuar në kushtet dhe rregullat dhe procedurën e përcaktuar saktë” si dhe nenin 6 të LPP-së – Ekonomiciteti dhe efikasiteti, sipas të cilit, citat “ Autoriteti Kontraktues është i obliguar që të siguroi që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit “mbarim i citatit.***

Bazuar në :

- obligimin e A.K. për kujdes në përdorimin e fondeve dhe burimeve publike;
- faktin se kontrata për këtë aktivitet të prokurimit është kontratë kornizë, se sasitë e artikujve dhe/ ose shërbimeve indikative që janë parashikuar të blihen përmes këtij aktiviteti të prokurimit nuk kanë qenë të ditura për A.K., A.K. bazuar dhe në njohuritë paraprake të tija gjatë një periudhe të gjatë kohore nuk ka pasur fare blerje të shërbimeve të tilla të specifikuar në pikën E nënpika 2 " Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponinë regjionale të menagjuar nga UNITETI " dhe nënpika 3 " Ngarkimi dhe transporti i mbeturinave ushqimore dhe jo ushqimore (mbetjet e asgjësimit) si dhe mbeturinat shtazore ,deri në deponinë regjionale të menagjuar nga UNITETI ";
- në nenin 28.12 të RUOPP ka konstatuar se : ***frekuenca dhe rëndësia e artikujve gjegjësisht shërbimeve të cituara si më lartë në këtë vendim është e një rëndësie shumë më të ulët,***
- faktin se O.E. " Urban O.P. " sipas vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve rezulton të jetë tender i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të poentuar;

si A.K. kemi konkluduar se duke rekomanduar për dhënie të kontratës O.E. " Urban O.P. " kemi përmbushur kërkesat nga nenin 6 i LPP-së, sepse me këtë kontratë fondet publike do të shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe transparente, neni 7 i LPP-së, sepse A.K. gjatë zbatimit të nenit 59 të LPP-së ka pasur kujdes që të gjithë O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit ti trajtoi barabartë dhe jo në mënyrë diskriminuese, që mos të redukton konkurrencën e drejtë në mes O.E. si dhe të mos diskriminoj në dëm ose në të mirë të një O.E. , nenin 60 të LPP-së, sepse me dhënie të kontratës është rekomanduar O.E. i cili ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët të peshuar.

Më tej A.K. vlerëson se pretendimi i Ankuesit i paraqitur në Kërkesën për Rishqyrtim të dt. 19.04.2021, se A.K. nuk ka zbatuar Vendimin e OSHP-së nr. 177/21 të dt. 25.03.2021 është plotësisht i pasaktë dhe i paqëndrueshëm sepse A.K. , mbi bazën e pikës II të Vendimit të OSHP-së nr. 177/21 dt. 25.03.2021, ka zbatuar në plotni procesin e rivlerësimit bazuar në nenin 59 të LPP-së, mbështetur në rezultatet e rivlerësimit, shpjegimet e ofruara nga O.E. dhe rezultatet e nxjerra nga procesi i zbatuar sipas nenit 61 të LPP-së lidhur me Tenderët jo-normalisht të ulët si dhe bazuar në nenin 28 të RUOPP Kriteri për Dhënien e Kontratës si dhe nenin 116 pika 6 të LPP-së sipas të cilit, citat : “ **Një vendim i OSHP-së për Ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar** “ A.K. ka vendosur si në Njoftimin mbi vendimin e A.K. si dhe në dispozitiv të këtij vendimi. Pretendimi tjetër i Ankuesit se vendimi i A.K. është i ndikuar nga interesat personale për të favorizuar një O.E. dhe për të dëmtuar një O.E. tjetër i gjason më tepër një deklaratë politike, një deklaratë e cila nuk ka mbështetje ligjore dhe e cila nuk mundë të argumentohet me asnjë fakt, përkundrazi vendimi i A.K. sikurse ka konkluduar, dhe sikurse ka sqaruar më tej në këtë vendim, është marrë mbi bazën e dispozitave të **nenit 1, Qëllimi, nenit 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti, nenit 7 Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi dhe nenit 59 lidhur me nenin 60 – Kriteret për dhënien e kontratës të LPP-së, ndërsa sa i përket pretendimit se rritja e sigurimit të ekzekutimit të kontratës për O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës është bërë në mënyrë të kundërligjshme, A.K. sqaron se mbështetur në dispozitat e nenit 30.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik më tej (RUOPP) një vendim i tillë është plotësisht në pajtim me dispozitat ligjore të cilat rregullojnë çështjen e Sigurimit të ekzekutimit të kontratës dhe është në diskrecion të A.K.**

Andaj, Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë në tersin e saj, ndërsa Vendimi i ankimuar i A.K. është i bazuar në dispozitat e LPP-së dhe RUOPP.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se pretendimet ankimore të Ankuesit janë plotësisht të paargumentuara dhe për rrjedhojë të pa bazuara, andaj A.K. konstaton se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Kundër këtij vendimi, parashtruesi i Kërkesës për rishqyrtim mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

**Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 083/2020 - datë 26/04/2021**

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtoria për Prokurim Publik


Amir Haradinaj, ZPP